



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



01 Nr. 070-38505 dt. 05.07 2019

PROCESVERBALI

Tubim me Publikun

Mbledhjen e hapi z.Bekim Dobra duke filluar në ora 10:00 më 19.06.2019 ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci, përfaqesues të KFOR-it, përfaqesues të OSBE-së, Drejtor të Drejtorive komunale, administrator të fshatrave, përfaqesues të lagjeve dhe shumë qytetarë



Rend dite:

Në këtë tubim me publikun përfaqësuesit e Komunës do të informojnë pjesmarresit për aktivitetin e komunës për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për të arriturat, vështirësitë dhe synimet si dhe investimet kapitale, ndersa pjesmarresit mund t'u shtrojnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmujorin e parë dhe çështje tjera më interes të qytetareve të Komunës.

Bekim Dobra- I nderuari kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, drejtor të drejtorive komunale, anëtar të Kuvendit të Komunës, administrator të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, organizatave jo qeveritare, ju qytetarë.

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin gjatë gjashtëmujorit të parë, të vitit fiskal, pra ky qe ne sot po e mbajmë, dhe tjetri në fundvit.

Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë njoftimin dhe ka publikuar dy javë para në ueb faqe të Komunës, në rrjetin social të Komunës, njoftimi është vendosur edhe ne dy hyrjet e objektit të Komunës, është vendosur edhe në vendet me të frekuentuara si dhe në mediat online.

Të nderuar të pranishëm,

Ndjej për obligim të ju njoftoj për rregullat e takimit!

Tubimi me publikun ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës ju njoftojnë për aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë pjesës së dytë të këtij viti, ndërsa ju të pranishëm, mund të bëni pyetje dhe të jepni propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit dhe çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Ftojë Kryetarin e Komunës, z. Ramiz Lladrovci të përshëndet takimin.

Për të elaboruar aktivitetet e Komunës ne gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për sukseset dhe sfidat, ftoj drejtorin për Infrastrukturë Lokale, z. Idriz Hysenaj.

Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht kur të merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit për t'i adresuar kërkesat, apo sugjerimet tuaja.

Fjala është për ju!

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- i përshëndeti të gjithë dhe i falënderoj për pjesëmarrje në këtë takim, sot jemi në një takim me publikun, të cilën jeni të interesuar me ditë se çka kemi punuar deri me tani dhe çka jemi në zhvillim e sipër. Unë dua t'ju njoftoj se Komuna e Drenasit e ka pas buxhetin fillestar prej 15.171.602 euro por për shkak të performancës së mirë, për shkak të transparencës, për shkak se ne kemi bërë punë të mira këtë buxhet kemi shtu nga grandet të ndryshme të performancës së mirë prej 6.25% që i bie se tani e kemi rrit buxhetin prej 16.177.231.87 euro e këto grande i kemi fituar si nga Qeveria Japoneze 64 mijë euro për projektin e mamografit të cilën e kemi siguruar për qytetaret tanë, nga Qeveria Zvicerane shumë prej 133. 439 euro nga MAP i kemi përfituar 2 grande një grand 60 mijë euro dhe një grand për barazi gjinore prej 20 mijë euro, kemi fituar grand nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në shumë prej 70 mijë euro por i kemi edhe 100 mijë të vitit të kaluar që e rrit përqindjen që shkon afër 7%, si dhe e kemi përfituar grandin prej 100 mijë euro nga Ministria e Planifikimit Hapësinor ta pastrojmë ambientin tonë, po ashtu në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt e kemi fituar edhe një grand për Qiqavicën për fshatrat tona Gradicë ku do të hapet rruga në kurriz të Qiqavicës 300 mijë euro e që ne do të participojmë më mjete tona por edhe Komuna Skenderajt për ne ia mundesh gjitha fshatrave tona që të lidhen me fshatrat tona për me shfrytëzuar burime të ndryshme por edhe për vizita. Unë nuk do të flas shumë por janë edhe drejtoritë përkatëse të cilat do të ju njoftojnë për gjitha zhvillimet që janë bërë. Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Drejtore i Financave Shyqiri Bublaku- unë shkurtimisht do të ju informoj rreth performancës të hyrave dhe buxhetit të komunës për vitin 2019, gjithsej të pranimit gjatë pesë muajve të parë, gjithsej gjatë pranimit të pesë muajve të parë për vitin 2019 janë 9,685,556 Euro gjithsej buxhet i ndarë që e kemi pas në dispozicion për këtë periudhë kohore dhe paraqesin 63.84% buxhetit të përgjithshëm për vitin 2019 e buxhetit të aprovuar dhe certifikuar. Ndërsa me krahasua me buxhetin e vitit paraprak kemi një rritje të buxhetit prej 15.41%. Të hyrat buxhetore nga grandet qeveritar janë më shumë prej 8,690,390 euro duke shënuar një rritje prej 1.45% krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat tatimore të mbledhura në tatimin në pronë kanë arritur vlerën prej 166,176 mijë euro kemi një rënie të hyrave të realizuara në tatimin në pronë por shkak i kësaj rënie të hyrave është vonesa për shkak të tatimit në pronë që ka hyrë në vitin 2019 dhe faturat janë vonuar me iu shpërndarë qytetareve dhe kjo ka ndikuar edhe në zvogëlimin e të hyrave nga kjo kategori. Të performanca e shpenzimeve, te

shpenzimet gjatë pesë mujorit të parë për vitin 2019 paraqesin një shumë prej 4,549,944 Euro apo afër 30%, pse kjo përqindje nuk është me e madhe është se investimet në periudhën e parë pra ne fillojmë me investime kapitale prej muajit mars, shpallen kontratat e para gjegjësisht hartohen projektet e para dhe ajo ndikon që pjesën e parë të kemi një shpenzim pak më të vogël të buxhetit për këtë periudhë kohore. Të shpenzimet paga dhe mëditje vlera e shpenzuar është 3,402,644 euro gjatë këtij pesë mujori duke arritur normën e ekzekutimit prej 40,39%, krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar. Shpenzimet për pagat gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 2.35% krahasuar me vitin paraprak. Shpenzimet për mallra dhe shërbime që kanë vlerën prej 563,314 euro duke e shënuar kështu normën e ekzekutimit prej 32.83 krahasuar me vlerën totale buxhetore për vitin 2019, shpenzimet e shërbimeve komunale shënuan vlerën e shpenzimeve prej 60.64 euro këto shpenzime hyn për ujë, mbeturina dhe këto ja kanë rrit vlerën prej 31.76 %. Subvencionet dhe transferet, kemi rritje realizim ose shpenzim të mjeteve buxhetore me shumë prej 24.664 euro të kjo shumë ka ndikuar aprovimi i rregullores në nivelin qendror e cila ka ndikuar që të startojmë më vonë me shpalljen e konkurseve për organizatat jo qeveritare të cilat duhet të garojnë për përfitimin e këtij grandi. Shpenzimet kapitale-në shpenzimet kapitale kemi vlerën e shpenzuar prej 499,306 euro që paraqet një normë më të ulët krahasuar me vlerën totale buxhetore të këtij viti, por kemi rritje. Mirëpo duke u bazuar në performancën e komunës kemi realizuar edhe grande, dhe vlera e investimeve kapitale ngritët për vitin 2019 total 5, 600,11 mijë pa i numëruar disa rrugë, të cilat investon niveli qendror, dmth buxheti i aprovuar ka qenë 5,176,000 dhe kemi arrit në 16,177,231 euro . I falënderoj të gjithë për vëmendjen.

Drejtor i Infrastrukturës lokale Idriz Hysenaj- i përshëndeti të gjithë. Ne deri më tani shumë procedura kemi filluar, jemi duke punuar në vazhdim, do t'ia lexoj një arsyetim të këtyre projekteve që kanë filluar : rregullimi i shtratis Drenica dhe Verbica janë dy llotot janë duke u punuar, e treta sot nënshkruhet kontrata, loton e katërt jemi duke prit për me u shpallë, ne gjatë këtij viti planifikojmë që tërë shtrati i lumit "Drenica" të pastrohet, të thellohet dhe zgjerohet , që fillon nga guri i plakës deri në Nekoc, dhe prej Gllobarit deri në Verbovc dhe Polluzhë, tjetër degëzim është Vukovc-Negroc dhe Korretice e Ultë dhe Korreticë e Naltë gjitha këto janë në procedura të tenderimit pjesa tjetër është duke u kry punimet dhe vazhdojmë tjerat deri në lidhje të kontratës, ky do të jetë një prej projekteve që përfshinë një pjesë të buxhetit më të madh të komunës sonë dhe krahas kësaj ne

do të shkojmë edhe grumbullimin e ujërave të zeza në kolektorë rreth lumit, kryhet pastrimi i lumit, drejtimi i tij dhe fillon faza e kolektorëve rreth lumit shuma e shtratit të lumit ka qenë e buxhetit tonë 350 mijë euro kemi fitu grand siç e përmendi edhe kryetari 170 mijë euro, grandit ne përformances 70 mijë euro, dhe 100 mijë euro grandit "ta pastrojmë Kosovën" që i kemi dedikuar në këtë projekt, ndërtimi i kolektorëve dhe grumbullimi i ujërave të zeza në Komunën e Drenasit buxheti është 480 mijë euro, ne vetëm kemi filluar procedurat e prokurimit që menjëherë pas pastrimit të lumit vijnë kolektorët, këto janë dy projekte që ndërlihen njëra me tjetrën dhe vazhdojnë punimet. Rregullimi i infrastrukturës , trotuareve dhe ndriçimi në Komunën e Drenasit është në përfundim të hartimit të paramanës dhe parallogaritë për me vazhduar projektin. Ndërtimi i infrastrukturës se asfaltimit dhe kubzave ne Komunën e Drenasit I,II,III,IV janë duke vazhduar punimet në këtë projekt. Infrastruktura në Komoranin I,II,III,IV janë duke u zhvilluar punimet, janë disa segmente të kolektorëve dhe gypave të kanalizimit, kryesisht në pranverë fillojmë me kanalizime që na mundëson me punuar. Ndërtimi i urave dhe turbinave kontrata jemi në proces të nënshkrimit të kontratës, është ura në Fushticë, në rrugën e Kishnarekës, në Zabel në Terstenik, në Vërbovc janë katër ura, ri ura të mëdha dhe dhe tri turbina, ura në Dobroshefc është projekt i vitit të kaluar, kemi ngecje për shkak të mungesës së projektit të vlerave të armatures në projekt. Asfaltimi i rrugës Gllanasellë-Godanc është në bashkëfinancim me MAPL-në e kemi fituar një grand afër 60 mijë euro dhe 20 mijë tjera gjithsej janë 80 mijë euro që po presim bashkëfinancim me ta. Asfaltimi në fshatin Terstenik I,II është nënshkruar kontrata edhe pak ditë fillojnë punimet edhe për këtë rrugë. Asfaltimi i rrugës Poklek i vjeter-Poklek i ri- Vasilevë është nënshkruar kontrata, infrastruktura në fshatin Abri-Terdevc në proces të prokurimit, Asfaltimi i rrugës Dobroshefc janë duke vazhduar punimet, asfaltimi i rrugës Baicë- Krajkovë- Damanek janë në proces të prokurimit, ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Nekoc-Kishnarek në proces të hartimit të paramanave dhe parallogarive, asfaltimi i rrugës Gradicë-Likoshan në proces të hartimit të paramasave, asfaltimi i rrugës Arllat-Negroc-Gjergjicë si dhe bytyq në proces të prokurimit, asfaltimi i fshatit Sankovc-Fushticë e eperme dhe Fushticë e ulet është nënshkruar kontrata, pritët të fillojnë punimet, asfaltimi i fshatit Terdevc-Vuçak është në proces të prokurimit, asfaltimi i fshatit Shtuticë-Vërbovc-Polluzhë është nënshkruar kontrata, asfaltimi në fshatin Llapushnik- Potorrk dhe Vukovc është nënshkruar kontrata pritët të fillojnë punimet, asfaltimi i rrugës Zabel i Ultë-Korroticë e Ulët dhe e Epërme në proces të prokurimit, ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas nuk ka aktivitete për shkak të procesit të hetimeve, ndërtimi

i shtëpive të skamnoreve në bashkëfinancim me donatorët presim që të kemi donator edhe të bashkëfinancim. Bashkëfinancim i projektit me donator të jashtëm, bashkëfinancimi me ministri që e cekem me herët, mbikëqyrja e projekteve kapitale në Drenas është në proces të prokurimit, hartimi i projekteve zbatuese për nevojat e punës është dërguar në zyret e prokurimit, rregullimi i vend daljeve dhe mbulimi i tyre është një projekt i cili nuk kemi filluar ende paramana dhe parallogarive, hapja e kanaleve kulluese rreth rrugëve në Komunën e Drenasit janë duke u zhvilluar punimet në drejtimin e Gllanaselles Gradices-Likoshan vitin e kaluar e kemi përfunduar një pjesë tjetër, kanalizimi i ujërave të zeza në Komunën e Drenasit jemi duke prit projektin për me shpall sepse është pak me e komplikuar nëpër qytet. Me kanalizimet kemi filluar në fazën më të hershme, në fshatin Komoran I.II.II janë duke u zhvilluar punimet, kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Arllat, Negrovci janë duke vazhduar punimet, kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Sankovci, Fushticë e Eperme dhe Fushticë e Ulet në proces. Kanalizimi i ujërave të zeza në Korreticë e ulet, Poklek i vjetër dhe i Poklek ri është nënshkruar kontrata pritet të fillojnë punimet, kanalizimi i ujërave të zeza Dobroshefc- Qikatovë e re dhe Qikatovë e vjetër janë duke u zhvilluar punimet, kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Abri, Terdevci, janë duke u zhvilluar punimet, kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Gllanasellë, Godanci janë duke u zhvilluar punimet, Likoshan, Gllanasellë janë duke u zhvilluar punimet, Llapushnik, Potorrk, Vukovci janë duke u zhvilluar punimet, kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Nekovci, Kishnarek janë duke u zhvilluar punimet dhe kanalizimi në fshatin Shtuticë-Verbovci janë duke u zhvilluar punimet janë para përfundimit dhe fshatin Baicë, Krajkovë është nënshkruar kontrata, nuk kanë filluar ende punimet por shumë shpejt do të fillojnë. Këto janë ato projekte që kanë qenë vitit të kaluar kanalizimet janë para përfundimit, rrugët fillojnë këtë muaj dhe shpresojmë që do t'i përfundojmë me kohë.

Imri Bajraktari-Çikatovë e Re- pati një pyetje për Drejtorinë e Arsimit, pse iu ka ndalë rryma në shkollën "Ali Gashi" si dhe sa i përket sanitarisë banjo është në gjendje jo të mirë, dyert janë të prishura ujë nuk ka kërkoj t'i rregulloni këto çështje.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- sa i përket kësaj rrymës nuk kam njohuri, por KEDS-i nuk mund me shkyçë rrymën sepse unë kam bërë parapagesa nuk kemi borgje ndaj KEDS-it , mirëpo sa i përket sanitarisë ne çdo herë bëjmë

inspektim në shkolla dhe sa i përket shkolla është e gatshme çdo herë. Do ta dërgojmë një komision më verifikua përveç komisionit.

Xhemshir Noshori- Komoran III-pati një kërkesë për kanalizim të ujërave të zeza, z. Hyseni e ceku që është duke u rregullu kanalizimi në lagjen Buzhala ne jemi edhe 4 shtëpi mbi lagjen e Buzhaleve nëse ka mundësi edhe ne me u kyç ne atë kanalizim ju falënderoj shumë.

Drejtor i Urbanizmit Idriz Hysenaj- jemi duke punuar në atë pjesë dhe besoj që ajo pjesë do të përfshihet dhe do të rregullohet kanalizimi i ujërave të zeza.

Afrim Lushaku- Lagja "Feronikeli" -e pati një kërkesë për shtrimin e disa rrugicave të vogla e kemi bërë edhe kërkesë me shkrim të drejtori, ma ka kthyer se do ta shikojmë buxhetin desha, a ka diçka në këtë drejtim për me shtrë një rrugicë afër 160 m, kanalizimin e kemi rregulluar vet me vet iniciativë tonën nuk ka problem, por këtë projekt a ka mundësi me u realizu?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- ne nuk kemi drejtë me investu në lagjen "Feronikeli" për shkak se prona është e tjetër kujna, disa lagje ku është prona e Feronikelit nuk kemi për detyrë me investu ndërsa për prona private do t'i zgjidhim të gjitha një nga një. Ato projekte që janë në zhvillim ju garantoj që do të zhvillohen deri në fund kurse ato që nuk janë në këtë afat në projekte bëhen vitin e ardhshëm.

Fadil Tiku-Verboc- i falënderoj për gjithë ato punë që janë bërë, kërkoj që të rregullohet kanalizimi i ujërave të zeza në lagjen "Zhushi" kanalizimi i ujërave të zeza në lagjen "Tiku" kemi asfaltimin në rrugën "Ymer Zhushi" asfaltimi i rr."Jahir Gllareva " asfaltimi në rr. " Behush Prokshi" janë rrugë primare që duhet të punohen. Tabelat ende nuk kanë ardh, dhe çështja e trojeve çka është bërë?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- në fshatin Verboc jemi duke punuar duke i zhvillu projektet, ju e keni shikuar në buxhet çka është e planifikuar, mos kërkon diçka që nuk është e planifikuar, të premtën është dëgjimi publik për projektet që nuk i kemi me kërkuar dhe me i fut në projektet e vitit të ardhshëm. Sa i përket tabelave të rrugëve ne jemi duke e zhvillu projektin. Çdo gjë që është në projekt janë duke u zhvilluar punimet dhe nuk mbeten punimet pa u zhvilluar, sa i përket

trojeve, trojet i ka keqpërdor komisioni për dhënien e trojeve, ndërkohë që ajo pronë është e tjetër kujt.

Florim Kiqina- Baicë- në fshatin tonë ka filluar që disa ditë kanalizimi i ujerave të zeza, por a përfundon këtë vit?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- aq sa është e paraparë ato do të përfundojnë.

Nazmi Shehu - Dobroshevc- kërkoj një sqarim puna urës çka është bere a kur do te fillojnë punimet? Dhe unaza nga lagja "Fejza" deri tek lagjja "Caraku" a është në projekt ?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ura do të behet punimet do të vazhdojnë dhe do të përfundojnë këtë vit, por i kem ndal punimet sepse ne projekt ka ardh kërkesa me shtru 10% të shumës për me përfundu urën, ne kur e shpallim një projekt e shpallim dhe nuk ka më shtesa, sa i përket unazës jemi duke e rregulluar rrugën në lagjen "Fejza" do ta bëjmë edhe ata unazë. Sa i përket ujësjellësit

Kadri Ajazi- Sankoc-pati një pyetje për Drejtorin e Urbanizimit, asfaltimi tani që do te fillon, a ka mundësi aty ku ka mbet vitin e kaluar asfaltimi dy anët të vazhdohet, dhe ankesat nga kush po vijnë? edhe një pyetje për drejtorin e shëndetësisë a do të fillon mjeku me punu dhe infermierja në ambulantë në Sankovc. Sa i përket ujësjellësit në vitin 2001 e kemi marr vet me mjete vetanake atëherë pas disa viteve na morën ato pompa dhe para3-4 viteve kemi diskutuar në komunë dhe prapë na kanë mundësuar ta vemi në funksion ujësjellësin tonë por prapë po kemi problem se nuk po mundemi me menaxhuar ne vet, që 1 vit kemi mbet shumë keq, a ka mundësi me na ndihmuar që me menaxhu ujësjellësin si duhet.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- çdo projekt që ka qenë në buxhet të vitit të kaluar do të përfundoj këtë vit, ndonjë që është 2 vjeçar zgjat ma shumë por do të përfundojnë dhe nuk do të mbetet asnjë pa u kry. Sa i përket ambulantes, ajo ambulant i ka 7 vizita në muajt, nuk ka vizita të shumta, për ata ne e kemi bërë shërbimin 24 orë në Komoran. Dhe për çdo parregullsi gjatë punimeve që i vëreni ju lutem me informoni dhe do dalim ta shikojmë, unë kërkoj bashkëpunimin e juaj çdo herë.

Drejtor i Urbanizmit Idriz Hysenaj- sa i përket rrugës ato metra që janë të planifikuara ato do të përfundojnë. Ndërsa sa i përket ujësjellësit ju e keni një kërkesë nga ujësjellësi për me hy ne sistem ndërsa ju nuk keni pranuar me hy ne sistem, duhet me hy ne sistem për me pas ujë, shërbimet duhet t'i paguani.

Albert Nika- Gllanasellë- sot i kam disa kërkesa që i kemi drejtuar drejtorive përkatëse për realizimin e projekteve në fshatin Gllanasellë në të njëjtën kohë dua t'iu falënderoj për gjitha ato projekte që janë bërë deri më tani. Kërkoj nga drejtoria përkatëse të vazhdoj për rregullimin e kanalizimit të ujerave të zeza lagjet që kanë mbet pa u kyç sipas kornizës buxhetore 2019-2021 që kanë mbet afër 250 m, në lagjen "Maloku" dhe në lagjen "Krasniqi" dy pjesë afër 400 m kanalizim që të përfundohet komplet kanalizimi në fshatin Gllanasellë. Takimin që e keni mbajtur ne fshatin Dobroshec për pranimin e kërkesave për kornizën buxhetore 2019-2021 unë i kam adresuar kërkesat me kohë për çdo lagje, buxheti që është paraparë për asfaltimin e rrugës në lagjen " Nika " në Gllanasellë kërkoj nga ju pasi që është dorëzuar kërkesa me 50 nënshkrime, që asfaltimi të fillon në këtë pjesë ky buxhet që është paraparë apo në këtë vit të rregullohet asfaltimi. Dhe në fshatin Gllanasellë i kemi 4-5 vena varrezat kërkoj nga ju të ndërmer masa drejtoria e gjeodezisë t'i legalizon këto varreza. Për drejtorinë për emergjencë dhe shërbime publike janë adresuar disa kërkesa për zhvorr kërkoj nga ju që t'i merrni në shqyrtim ato kërkesa të cilat janë të arsyeshme dhe janë në të mirë të banoreve të fshatit Gllanasellë.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- projektet të cilat janë të parapamë do të përfundojnë. Do t'i bëjmë të gjitha projektet dhe kam thënë që për dy vite nuk ka me pas lagje të paasfaltuara dhe pa kanalizim të ujerave të zeza.

Murat Bylykbashi-Terstenik- ju falënderoj për punë në që keni bërë në Terstenik I, një gjë që na shqetëson rruga 4 korsi sipas mendimit tim ka devijuar pak dhe për shkak të asaj nuk ka mundësi trotuari me u bë 1.50 m se duhet me hy prona private pastaj, desha me dit ehe rrethi që është shpronësuar rruga vetëm është unë përfundim as nuk është shpronësuar as nuk na ka kontaktua askush, a e mbikëqyrni atë projekt komuna apo vetëm të ministrisë.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- rrugën e shtron Ministria e Infrastrukturës mbikëqyrjen e kanë ata,

Zenë Halilaj- Tërdec- e kam një kërkesë për drejtorin e Urbanizimit në lagjen e “Dëlrëve” kanalizimi është shumë keq ujërat e zeza ecin nëpër rrugë kërkoj nga ju që keni mundësi me ndërhy sa ma shpejt për atë kanalizim të ujërave të zeza.

Skender Bogiqi- Komoran –IV, për projektet që kanë qenë vitin e kaluar ne jemi të kënaqur sepse ehe këtë vit kanë vazhduar kanalizimi i ujerave të zeza është përfunduar edhe me cilësi por edhe ne sasi sipas asaj çka ne kemi mundur me vërejt, e kam një pyetje të cilën nuk kam dit ku me u adresuar, është një kanalizim i një pjese të fshatit pas market “Jora” ai projekt i kanalizimit është ndërtuar në Llapushnik para 7 viteve dhe tani banoret po ankohet se ujërat e zeza po iu kthehen në shtëpi, e kanë mbyllë ne mes atyre shtëpive dhe ato kanalizime derdhen neper fusha dhe është shuma i dëmshëm, kërkoj nga ju me shiku apo me bërë pastrimin apo me be ndonjë përmirësim për shkak se aty është problem i madh.

Faik Nishori- Komoran II- pati një kërkesë një rrugë tek varrezat 1300m janë a ka diçka për të dhe rruga që lidh lagjen “Zogu” dhe “Nishori” dhe tek lagjja “Ibriqi” rruga që është shtruar është thy një shakt ka mbet shumë keq kam bërë kërkesë po ende nuk e keni rregulluar.

Drejtore i Urbanizmit Idriz Hysenaj- sa i përket rrugës nuk kemi buxhet këtë vit, sa i përket pesetës i kemi marr vërejtjet, asfaltimi i lagjes “Zogaj”-“Nishori” është ne prioritetet që do te shtohet.

Blerim Sinani- Korreticë e Poshtme-pati një kërkesë një urë kalon ne mes të fshatit të cilën kalojnë nxënësit për ne shkollë është e ngarkuar dhe është shumë rrezik.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- do ta autorizoj drejtorin më i shkru edhe një herë Ministrisë sepse ne nuk kemi drejtë me invesu në rrugë regjionale, do ta bëjmë kërkesën dhe besoj se duhet me u zgjidh.

Fatmir Baliu- Shtuticë- i falënderoj për të gjitha projektet që keni bërë në fshatin tonë, kam një kërkesë më rrymë jemi shumë keq çdo ditë jemi të rrezikuar nga rryma, fëmijët munden me i prek telat me dorë, unë personalisht kam bërë kërkesa mirëpo asnjë përgjigje nuk më është kthyer, kam qenë në Skenderaj kurrfarë përgjigje nuk na është kthyer se e kemi rrymën me Skenderaj por ende nuk ka diçka.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- me 27 qershor ne e përrurojmë trafostacionin më modern në Drenas i cili ka me qenë në shërbim të gjithë qytetarëve të Drenasit, unë i kam bërë kërkesa që ato fshatra tona që janë të lidhura me Skenderajn apo Malishevën apo me ndonjë qytet tjetër të kthehen dhe të jënë në sistem me komunën tonë.

Bekim Dobra-i falënderoj të gjithë për pjesëmarrje në këtë takim.

Takimi përfundoi rreth orës: 11:50min



Procesmbajtëse:

Liridona Fejza Ajazi